



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 26 DHJETOR 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 26. DECEMBRA 2018. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2018**

Rendi i ditës

1. Adresimi i Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, Hashim Thaçi, deputetëve të Kuvendit të Republikës të Kosovës

Dnevni red

1.Obračanje Predsednika Republike Kosova, Njegovog ekxelenciji, Hashim Thaçi, poslanicima Skupštine Republike Kosova

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: I nderuar president i Republikës së Kosovës,
Shkëlqesia juaj, zoti Hashim Thaçi,
Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar përfaqësues të organizatave joqeveritare,
Të nderuara media,
Dhe ju të tjerë të pranishëm në këtë seancë,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Adresimi i Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, Hashim Thaçi, deputetëve të Kuvendit të Republikës të Kosovës

Të nderuar deputetë,
Presidenti i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, në pajtim me nenin 84, paragrafi 30 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës do ta mbajë fjalimin vjetor përkitazi me fushëveprimtarinë e tij.

Ftoj presidentin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që ta marrë fjalën. Urdhëro, i nderuar president!

PRESIDENTI HASHIM THAÇI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit, z. Kadri Veseli,
E nderuar Kryesi e Kuvendit,
Të nderuar anëtarë të Qeverisë së Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Jam i lumtur dhe krenar të prezantoj të arriturat e Kosovës në këtë vit jubilar që po e lëmë prapa.

Në të njëjtën kohë Ju kërkoj falje për thirrjen e shpejtë të kësaj seance për shkak të agjendës që kam ditët e ardhshme.

Pra, të tregoj për rrugën që kemi përpara dhe mundësitë që sjell për zhvillim edhe më të madh të Republikës sonë.

Viti 2018 ishte vit jubilar, në të cilin shënuam dekadën e parë të shtetit të Kosovës.

Në dhjetë ditë festime në muajin shkurt janë shpalosur të arriturat e Kosovës në dhjetëvjetorin e parë në çdo fushë të jetës.

Duke u marrë me çështjet e përditshme nganjëherë harrojmë të shohim se sa larg kemi arritur. Prandaj, dhjetë ditë festë ishin rast i mirë për të kujtuar se ku kemi qenë dhe ku jemi sot. Nga një vend i shkatërruar nga gjenocidi i ushtruar nga shteti i Serbisë, jemi ngritur në një shtet të pavarur e sovran:

- Me zhvillimin më të shpejtë ekonomik në rajon;
- Me legjislacionin më të avancuar në rajon;
- Me institucione demokratike, efektive e të qëndrueshme;
- Me suksese në shëndetësi e arsim, në shkencë e art, në sport e në kulturë.

I kujtuam sakrificat dhe angazhimin për liri.

Do t'u jemi përherë mirënjohës atyre që dhanë çdo gjë për lirinë që gëzojmë ne sot.

Dëshmorëve dhe familjeve të tyre.

Dhe, zotohemi që do të bëjmë çdo gjë që vuajtjet të mos përsëriten për askënd.

Këtë e bëjmë për gjeneratat që do të vijnë.

Por, e bëjmë edhe për qytetarët e sotëm të Kosovës, heronjtë e vërtetë të suksesit të Kosovës.

Fillimi i vitit 2018 shënon një sukses për Kosovën, për çka e falënderoi kryeministrin Haradinaj, ju deputetë që e votuat demarkacionin me Malin e Zi dhe i hapët rrugë vendit për të ardhmen, si dhe që eliminuat tendencën e themelimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe që tingëllonte sikur themelimi i një republike serbe në Kosovë. Si president i vendit zotohem se diçka e tillë nuk do të ndodhë në asnjë rrethanë.

Të nderuar deputetë,

Të nderuara zonja dhe zotëri,

Si president i vendit edhe në vitin 2018 kam përfaqësuar vendin, brenda dhe jashtë.

Kam pritur në Kosovë presidentin Pahor të Sllovenisë dhe presidentin Juncker të BE-së, kancelarin Kurz të Austrisë dhe ministrin e Jashtëm të Greqisë dhe shumë burrështetas dhe ministra e liderë të tjerë të botës.

Kam realizuar vizita bilaterale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Gjermani, në Britani të Madhe, por edhe në vendet e rajonit, në Bullgari, në Shqipëri, në Mal të Zi dhe në Maqedoni. Kam përfaqësuar Kosovën në forumet më të rëndësishme ndërkombëtare, si takimi i Forumit Ekonomik Botëror në Davos dhe takime të tjera të këtij forumi në Montreal të Kanadasë dhe Gjenevë të Zvicrës.

Po ashtu, e kam përfaqësuar edhe në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe në Forumin e Paqes në Paris. Kam përfaqësuar Kosovën edhe në Samitin e Sofjes të BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, në Samitin e Alpbach në Austri, në Konferencën e Sigurisë së Munihut.

Por, edhe në hapjen e Lojërave Olimpike Dimërore në Kore. Në Jerevan të Armenisë, së bashku me ministrin e Jashtëm Pacolli, në samitin e vendeve të Organizatës së Frankofonisë kemi avancuar postin tonë nga shtet vëzhgues në anëtar të asociuar.

Në të gjitha këto forume kemi bërë të qartë që Kosova është e përcaktuar për paqe të qëndrueshme në rajon dhe më gjerë. Që Kosova është e përkushtuar për dialog dhe paqe. Që Kosova angazhohet me tërë forcat që sa më parë të bëhet anëtare e NATO-s dhe e BE-së.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Edhe viti 2018 ka pasur momente kur është bërë i rëndë dhe kur kemi përjetuar humbje.

Këtë vit kemi humbur Adem Demaçin dhe Fadil Vokrrin. Nuk ka fjalë që përshkruajnë këto humbje. Do ta ruajmë dhe nderojmë kujtimin duke vazhduar të punojmë për atë që ëndërronin edhe ata.

Dhimbje kemi përjetuar edhe nga mospranimi i Kosovës në Interpol, por edhe për shkak të vonimit të vendimit për liberalizimin e vizave për qytetarët tanë nga ana e BE-së.

Jam krenar që si shtet, si shoqëri, kemi bërë çdo gjë që është kërkuar nga ne. Kemi plotësuar çdo kriter, edhe për anëtarësim në Interpol, edhe për liberalizim të vizave. Mungesa e vendimit të drejtë në këto dy raste nuk është humbje për ne.

Por, nuk është as dekurajim që të vazhdojmë për forcimin e shtetit tonë. Këtë e bëjmë, sepse mbi të gjitha është në interesin tonë, në dobinë tonë.

Jemi përballur edhe me plagët e hapura nga e kaluara e dhimbshme.

Kam emëruar Ekipin Përgatitor për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin.

Kam dekoruar zonjën Vafije Krasniqi-Goodman për guximin që të flasë hapur dhe të kërkojë drejtësi për vete dhe për mijëra viktime të tjera të dhunës seksuale, të ushtruar nga forcat policore dhe ushtarake të shtetit serb gjatë luftës në Kosovë.

Jam ndier krenar sidomos me të arriturat e artistëve dhe sportistëve tanë. Si çdo qytetar tjetër i Kosovës, jam krenar me të arriturat e këngëtareve tona në botë, me të arriturat e piktorëve dhe arkitektëve.

Jam krenar me të arriturat e të xhudistëve. Me të arriturat e futbollistëve tanë. Është bërë e gjatë lista për t'i përmendur me emër një nga një.

Si president më ka gëzuar fakti që kam dekretuar pakon e ligjeve për reformën në sistemin e drejtësisë. Që nga dita e parë në Zyrën e Presidentit, jam angazhuar që të përkrah sa më shumë fuqizimin e drejtësisë.

Kjo pako që përfshin ndryshimet në Kodin Penal, Ligjin për gjykatat, për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Ligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë dhe ligje të tjera, që do të forcojnë edhe më tutje sistemin tonë të drejtësisë.

Natyrisht Kosova ka nevojë për qeverisje edhe më efektive, edhe më efikase, edhe me afër qytetarëve, të realizojnë edhe më shumë të drejta për një jetë edhe më të mirë. Shpresoj për angazhimin e të gjithëve, sepse qeverisja e vendit duhet të jetë në përputhshmëri me vullnetin dhe zotimet e qytetarëve. Çdo punë e mirë do ta ketë përkrahjen time si president.

Por, zonja dhe zotërinj,

Jam ndier veçanërisht i lumtur dhe krenar që tek unë kanë arritur për dekretim tri ligjet, me të cilat hapet rruga që Forca e Sigurisë së Kosovës të bëhet ushtri e Kosovës.

Shpesh jam ndier i vetmuar në angazhimin tim për themelimin e ushtrisë së Kosovës. Por, jam i lumtur që në fund i tërë spektri politik i Kosovës u bë bashkë rreth këtij synimi për transformimin e FSK-së. Ushtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës u them se ata e kanë merituar që moti këtë. Me punën e tyre, me profesionalizmin e tyre, ata që moti janë ushtarë të Kosovës.

Forca e Sigurisë së Kosovës do të vazhdojë të mbetet forcë profesionale e standardeve të NATO-s, forcë shumetnike, në shërbim të të gjithë qytetarëve dhe në shërbim të paqes në Kosovë, në rajon dhe më gjerë.

E mirëpres edhe faktin që spektri politik kosovar ka filluar të bëhet bashkë rreth sfidave dhe mundësive imediate për shtetin tonë. E theksoj për rritjen e mirëqeverisjes, përgjegjësisë, transparencës, luftës kundër korrupsionit dhe kriminit të organizuar dhe thellimit të reformave demokratike. Uniteti i spektrit politik kosovar ka qenë dhe mbetet imediat në rrugëtimin tonë për sukses.

Në radhë të parë e kam fjalën për sfidën e arritjes së një marrëveshjeje paqësore me Serbinë. Me Serbinë kemi një shekull armiqësi. Shteti i Serbisë ka vrarë rreth 13 500 civilë shqiptarë në Kosovë, ka dhunuar rreth 20 000 gra shqiptare, rreth 1 milion qytetarë të Kosovës janë dëbuar dhunshëm deri në përmasa gjenocidi e spastrimi etnik. Rreth 40 % e infrastrukturës është shkatërruar nga shteti i Serbisë, me mijëra të zhdukur që ende nuk dihet për fatin e tyre dhe për fat të keq ende askush nga ai aparat i agresionit serb nuk është ndëshkuar, por është koha të shikojmë nga e ardhmja.

E kemi fituar luftën, ndonëse me çmim të lartë. Tani është koha ta fitojmë edhe paqen me Serbinë. Për veten tonë dhe për gjeneratat që do të vijnë.

Prandaj e mirëpres themelimin e Ekipit negociator nga Kuvendi i Kosovës dhe fillimin e punës për marrëveshjen me Serbinë. Ky Ekip negociator ka legjitimitetin dhe autoritetin të kryejë angazhimet e veta në përputhshmëri edhe me rezolutën e Kuvendi të Kosovës dhe do ta ketë përkrahjen time.

Marrëveshja me Serbinë duhet të jetë përfundimtare, gjithëpërfshirëse, e arritur në proces paqësor e të ndërmjetësuar nga Bashkimin Evropian dhe mbështetur plotësisht nga SHBA-ja.

Kjo marrëveshje duhet t'i sjellë Kosovës njohjen nga Serbia dhe anëtarësimin në Kombet e Bashkuara. Ndërsa, rajonit dhe Evropës do t'i sjellë paqe të qëndrueshme dhe stabilitet.

Të nderuar deputetë,

Dy letra të arritura në zyrën time këtë muaj tregojnë se jemi në rrugë të drejtë.

Letra e presidentit Macron të Francës e lavdëron angazhimin tonë për paqe e stabilitet. Por, edhe më e fuqishme është letra e presidentit Trump, e shtetit më të afërt me ne.

I jemi mirënjohës SHBA-së që në letrën e tij presidenti Tramp e dallon Kosovën si partner vendimtar për paqen dhe zhvillimin në tërë kontinentin e Evropës.

Duhet të marrim me seriozitetin më të thellë ftesën e presidentit Trump kur thotë që “nxis ju dhe

liderët e Kosovës që ta shfrytëzoni këtë moment unik” dhe “të flisni me një zë të vetëm gjatë negociatave për paqe”.

Kemi përkrahjen e mikut më të madh dhe shtetit më të fuqishëm, SHBA-së. Kjo na bënë të ndihemi krenarë si popullata më proamerikane në botë.

E kemi përkrahjen e BE-së dhe të shteteve anëtare të saj. E kemi përkrahjen e botës për të arritur marrëveshje paqësore, përfundimtare dhe gjithëpërfshirëse me Serbinë.

Të humbim këtë rast, siç thotë edhe presidenti Trump në letrën e tij, do të ishte kthim tragjik prapa dhe do të humbim një mundësi që nuk do të përsëritet edhe një kohë të gjatë.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot, si President i Kosovës, nga foltorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në emër të qytetarëve dhe lidërshiptit të Kosovës konfirmoj se Kosova është gati për dialog.

Kosova zotohet se do ta arrijë marrëveshjen finale me Serbinë që nënkupton marrëveshjen finale, njohje nga Serbia, ndryshimin e rezolutës 12 44, anëtarësim në OKB.

Lidërshipti dhe qytetarët e Kosovës presin me padurim bekimin e kësaj marrëveshjeje në Shtëpinë e Bardhë, nën lidërshiptin tuaj, i nderuar president Trump.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Urime festat e fundvitit, Krishtlindjet dhe Viti i Ri! Gëzuar! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

E falënderoj presidentin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, për fjalimin vjetor para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*